

STATUTI

I SHOQERISE "CENTRIUM" SH.P.K.

Ne mbeshitetje te Ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", si dhe te gjithë Legjislacionit Shqiptar ne fuqi.

Sot me datë **15.04.2024** ortak i vetem themelues:

1. **Z. Yassin CHKIR**, atesia Majed, shtetas Hollandez, lindur 26/01/1978 dhe banues ne Tirane ne Rrugen Gjergj Legisi , Nd. Nr. 15 , H.nr. 1

Te cilet hartojne kete statut te shoqerise "**CENTRIUM**" SH.P.K mbeshitetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "*Per tregtaret dhe shoqerite tregtare*", ligjin 9723 date 03.05.2007 "*Per Qendren Kombetare te Regjistrimit*", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, (me poshte "Shoqeria"):

KAPITULLI I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Themelimi, Forma, Emertimi

1.1 Sot me date **15.04.2024** krijohet shoqeria "**CENTRIUM**" SH.P.K. Ky emertim eshte i vetmi i shoqerise dhe perdoret ne te gjithë rregjistrimet, transaksionet, marreveshjet dhe komunikimet e saj me te tretet apo shtetin dhe eshte i vlefshem si jashte dhe brenda vendit.

1.2 Shoqeria "**CENTRIUM**" SH.P.K. eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, veprimtaria e te cilit do te rregullohet me ane te ketij Statuti dhe Aktit te Themelimit.

1.3 Shoqeria ka vulen dhe logon e saj identifikuese, ne formen dhe me ekstremitetet e caktuara nga ortakët e shoqerise.


1.4 Shoqeria vepron sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

1.5 Akti i themelimit dhe Statuti jane ne perputhje me legjislacionin shqiptar qe ka karakter te detyrueshem, ndersa ceshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuar ne to, plotesohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2

Themeluesi

Shoqeria themelohet nga shtetasi
- Yassin CHKIR



CENTRIUM

Neni 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise

3.1. Objekti i veprimtarise se shoqerise ne perputhje me legjislacionin tregtar aktual shqiptar do te jete:

Objekti i veprimtarise se shoqerise "**CENTRIUM**" **SH.P.K** do te perfshije por nuk do te kufizohet vetem ne veprimtarite e meposhtme:

Konsulenca ne projekte biznesi, mjedisore si dhe investime ne fushen imobiliare, dhenie me qera si dhe shitje te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme individe dhe persona juridik, konsulence ne fusha te ndryshme, rivlersim te pasurive te paluajtshme dhe te luajtshme, si dhe cdo aktivitet tjeter te pa shprehur persa i perket me siper. Eksport-Import te cdo lloj materiali Industrial, ndertimi, etj, te paisjeve kompjuterike dhe elektronike, te makinerive te ndryshme per transport individual dhe publik, te produkteve ushqimore, industrial, tekstile, kozmetike etj. Projektimin dhe ndertimin e ndertesave per banim si dhe shitjen e tyre.

Projektimin dhe ndertimin e fabrikave tekstile, industriale. Blerja shitja dhenia me qera e pasurive te paluajtshme. Import eksport dhe tregetim me shumice dhe pakice te rrobave te gatshme, tekstile, metrazhe etj. Hapja e hoteleve, restoranteve, bar kafeve si dhe cdo lloj aktiviteti qe ka lidhje me turizmin dhe i sherben atij. Per me teper Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter i cili nuk eshte i ndaluar nga ligjet ne fuqi.

3.2 Pershkrimi i objektit te shoqerise ka natyre indikuese dhe jo kufizuese. Per realizimin e qellimit te saj shoqeria mund te bashkepunoje me cdo person fizik apo juridik ne cdo menyre qe e gjykon te dobishme.

3.3 Shoqeria ne cdo kohe mund te ripercaktoje objektin e saj, ta shtoje apo pakesoje ate, me vendim te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.

Neni 4

Selia e shoqerise dhe deget

4.1 Selia e Shoqerise do te jete ne: Rruga e Kavajes, Qendra Gurten, nr. 10, Tirane

4.2 Transferimi i selise se shoqerise ne nje vend tjeter behet me vendim te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.

4.3 Shoqeria ke te drejte te operoje me zyra, filiale, dege apo agjenci ne te gjithe territorin e Shqiperise apo edhe jashte shtetit.

4.4 Zyrat, filialet, deget apo agjencite krijohen me vendim te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise, i cili organizon punen dhe emeron organet drejtuese dhe perfaqesuesit e tyre ligjor.

Neni 5

Kohezgjatja e shoqerise

5.1 Kohezgjatja e shoqerise "**CENTRIUM**" **sh.p.k** eshte e pakufizuar.

5.2 Ky afat mund te ndryshohet ne cdo kohe me vendim te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.

5.3 Shoqeria mund te priset ne cdo moment me vendim te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.

KAPITULLI II


KAPITALI THEMELTAR

Neni 6

Kapitali themeltar

6.1 Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njeqindmije) leke dhe perbehet nga 1 kuote

CENTRIUM



6.2. Ortaku themelues **Yassin CHKIR** është zoterues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 lek dhe që përben 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Ndryshimi i kapitalit themeltar

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, ecila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogelimi i prek ortakët në të njëjten masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 8

Fitimet që realizohen gjatë veprimtarisë dhe që konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike i perkasin ortakëve të shoqërisë, por kurdoherë pasi të jenë shlyer detyrimet ligjore.

Neni 9

Shoqëria "**CENTRIUM**" sh.p.k është përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo mund të blejë e të shfrytëzojë të drejtat e tjera materiale ose jomateriale duke përfshirë edhe të drejtën e shitjes së pasurisë së vet të të tretet.

Neni 10

Shoqëria "**CENTRIUM**" sh.p.k vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejtat e detyrimit vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët themelues të shoqërisë mbartin rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë vetëm deri në nivelin e kapitalit të investuar në të.

Neni 11

Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet :

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj

KAPITULLI III

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISE


Neni 12

Organi vendimmarres

12.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë për çështjet e mëposhtme

- Ndryshimin e Aktit të Themelimit dhe Statutit të shoqërisë;

CENTRIUM



- Miratimin e buxhetit vjetor te shoqerise, te raporteve te administrimit, te inventareve dhe bilancit e llogarive vjetore te saj;
- Emerimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar;
- Zgjedhjen e administratoreve dhe caktimin e detyrave e kompetencave te tyre, pervec atyre te percaktuara ne Statut;
- Aprovimin e garancive qe jep shoqeria;
- Miratimin e çmimeve dhe tarifave te mallrave apo sherbimeve qe ofron Shoqeria ne treg;
- Fillimin dhe nderprerjen e marredhenieve te punes me punemarresit e shoqerise;
- Caktimin dhe ndryshimin e shenjave dalluese te shoqerise si vula dhe logoja e saj;
- Mbikqyrjen e administratorit te shoqerise ne menyren se si ai kryen detyren e tij;
- Zhveshjen nga kompetencat te administratorit dhe kryerjen nga ana e tij te te gjitha veprimeve te administrimit te shoqerise ne emer dhe per llogari te saj;
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- Çdo kompetence tjeter qe i jepet nga ligji tregtar.

Neni 13

Administrimi

13.1 Administratori i shoqerise emerohet per nje afat 5 (pese) vjecar:

1. Administrator i shoqerise i emeruar do te **Z. Igli ZEPISHTA**, atesia Agim, shtetas Shqiptar, lindur 12/07/1966 dhe banues ne Tirane ne Rrugen Qemal Stafa nr. 246.
2. Neni 14

Kompetencat e Administratorit

Administratori pervec detyrave qe i cakton Asambleja e Ortakeve te Shoqerise ka edhe keto te drejta e detyra te tjera:


- Te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjithshme, te mireadministroje pasurine e shoqerise;
- Te lidhe marreveshje me te tretet brenda objektit te veprimtarise se shoqerise dhe kompetencave te caktuara nga Asambleja e Ortakeve te Shoqerise;
- Te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise.
- Te pergatise dhe te nenshkruaje bilancin vjetor , bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim.
- Te krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe e kercenojne mbarevajtjen e shoqerise dhe ekzistencen e saj.
- Kryejne regjistrime dhe dergojne te dhena te detyrueshme te shoqerise sic parashikohet ne ligjin per QKB-it.
- Te kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, shkelje te statutit apo per faj te kryer gjate administrimit te shoqerise Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise sipas neneve 14,15,17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Administratori detyrohet:

CENTRIUM



- Te zbatohet rregulloren e brendshme te shoqerise;
- Te shperbleje demet qe i vijne shoqerise si pasoje e veprimeve apo mosveprimeve te tij;
- Te paguhet per punen e kryer ne baze te marreshejs se bere midis tij dhe ortakeve te shoqerise.
- Te marre te dhena e te beje propozime mbi gjithshka qe ai e quan te dobishme per shoqerine;
- Te parandaloje dhe te menjenoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale mbi ata te shoqerise
- Te kryeje çdo detyre tjeter qe i ngarkohet nga Asambleja e Ortakeve te Shoqerise.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPERNDARJA E FITIMIT

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te çdo viti.

Perjashtimisht Viti i pare financiar perfshin kohen nga data e regjistrimit te Shoqerise ne Rregjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit dhe perfundon ne 31 Dhjetor te te njejtit vit.

Neni 17

Inventari dhe llogarite vjetore

17.1 Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe te veprimtarise se saj, ne pajtim me kerkesat ligjore.

Ne mbyllje te vitit financiar, administratori harton inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarite vjetore per vitin financiar.

Neni 18

Eksperti kontabel i autorizuar

18.1 Ne rast se kerkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakeve te Shoqerise, kontrolli i bilaneve dhe librave kontabel te shoqerise mund t'i besohet nje eksperti kontabel te autorizuar.

18.2 Eksperti kontabel i autorizuar mund te shkarkohet sipas menyres se parashikuar nga legjislacioni ne fuqi

Neni 19

Raportet Vjetore


19.1 Ne mbylljen e çdo viti financiar Administratori dhe eksperti kontabel (nese eshte emeruar) ben inventaret dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi per kontabilitetin si dhe harton nje raport me shkrim per ortaket e shoqerise.

19.2 Bilancit i bashkengjiten nje situacion mbi garancite e dhena nga shoqeria dhe nje situacion mbi sigurimet e bera nga shoqeria

19.3 Raporti pasqyron gjendjen e shoqerise gjate vitit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtarite e rendesishme, etj.

19.4 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabel te autorizuar (nese eshte emeruar) miratohen nga asambleja e ortakeve te shoqerise sipas ligjit 9901, date 14.04.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare"

CENTRIUM



Neni 20

Rezultatet e vitit financiar dhe caktimi i fitimeve

20.1 Rezultati i vitit financiar percaktohet si diference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit, duke perfshire te keto te fundit amortizimet dhe provizionet.

20.2 Shuma e fitimeve te mbetura pas heqjeve per krijimin e rezervave perfaqeson dividendin, i cili i shperndahet .

20.3 Duke perjashtuar rastin kur eshte vendosur zvogelimi i kapitalit, nga fitimet e vitit financiar nuk behet asnje heqje dhe asnje derdhje dividenti, ne qofte se kapitalet e veta jane ose do te beheshin me te vogla se shuma e kapitalit themeltar plus shumen minimale te kerkuar per rezerven e domosdoshme.

20.4 Ne qofte se ekziston nje humbje, kjo mbartet per t'u perfshire ne fitimet e vitit financiar te ardhshme deri ne shuarjen e saj.

Neni 21

Rezerva e domosdoshme dhe e nevojshme

21.1 Nga fitimi i rezervuar gjate vitit financiar pasi zbriten humbjet e vitit te meparshem, hiqet menjane nje shume e barabarte me 5 % (pese perqind) e fitimit e destinuar per formimin e fondit rezerve te quajtur "rezerve e domosdoshme".

21.2 Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme pushon se qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin 10 % te kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur per nje arsye çfaredo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nen 10 % te kapitalit.

21.3 Ortaket e Shoqerise mund te vendosin edhe zbritje te vecanta ne favor te rezervave te jashtezakonshme ose per qellime te tjera apo dhe shtyerjen e shperndarjes se fitimeve, plotesisht apo pjeserisht, per vitet financiare te ardhshme

Neni 22

Fitimi qe shperndahet

22.1 Koha, menyra dhe shuma e fitimit qe shperndahen vendoset rast pas rasti nga Asambleja e Ortakeve te shoqerise sipas raportit te administrimit ne perputhje me kete Statut, ligjin tregtar dhe gjendjen financiare te shoqerise.

KAPITULLI V

DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 23


Likuidimi i shoqerise

23.1 Menjehere pas marrjes se vendimit per prishjen e shoqerise, Asambleja e Ortakeve te Shoqerise cakton nje likuidator, kompetencat e tij dhe menyren e likuidimit te shoqerise, ne perputhje me dispozitat perkatese te ligjit tregtar.

23.2 Likuidatori i emeruar nga Asambleja e Ortakeve te Shoqerise menjehere sapo merr detyren eshte i detyruar te publikoje bilancin e shoqerise duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe t'ia vene ne dispozicion menjehere Asamblese se Ortakeve te Shoqerise.

23.3 Me caktimin e likuidatorit pezullohen te gjitha kompetencat e Administratorit dhe ato i kalojne likuidatorit.

CENTRIUM



DISPOZITA KALIMTARE

Neni 24

Dispozita te fundit

24.1 Per te gjitha çeshtjet qe nuk gjejne rregullim ne kete Statut, aplikohen dispozitat e ligjit Nr.9901 dt 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"

24.2 Per efekt te interpretimit te ketij Statuti me ligj tregtar nenkuptohet ligji Nr.9901 dt.14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

24.3 Pavlefshmerite eventuale te dispozitave te veçanta te Statutit nuk mund te cenojne vlefshmerine e tij.

Neni 25

Personaliteti juridik i shoqerise

Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Biznesit

Neni 26

Gjykata kompetente

Gjykata kompetente per zgjidhjen e te gjitha mosmarrveshjeve midis ortakeve dhe interpretimin e statutit te shoqerise eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 27

Hyrja ne fuqi

Ky Statut hyn ne fuqi dhe eshte i detyrueshem per zbatim ne momentin e firmosjes nga ortaket e shoqerise.

ORTAK I VETEM THEMELUES

I SHOQERISE "CENTRIUM" SH.P.K

Z. Yassin CHKIR

Yassin Chkir



CENTRIUM